



Thirrje për 6 Trajnerë/Ekspertë

Është një **thirrje e hapur** për trajnerët dhe ekspertët që do të zhvillojnë trajnimet në kuadër të projektit “Youth Guide for Durrës” i cili mbështetet nga Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)

Data e publikimit:

29/06/2019



Prezantim

Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, joqeveritare, jopolitike dhe e hapur për të gjithë ata që punojnë për realizimin e qëllimeve të saj. Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” është një shoqatë e themeluar në Durrës, Shqipëri me qëllim zhvillimi dhe menaxhim turizmi, të trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale dhe më gjerë me fokus në zhvillimin rajonal në fushat e sipërpërmendura dhe ato të ndërsjellta. Ky qëllim është në përputhje me strategjitë e Republikës së Shqipërisë në fushën e turizmit dhe të trashëgimisë kulturore si dhe me Kartën Europiane të Zhvillimit dhe të autonomisë rajonale.

Deri më tani shoqata ka zhvilluar një sërë projektesh dhe aktiviteteve të cilat lidhen drejtpërdrejtë me qëllimin e saj. Ndër to mund të përmendim projektin “**Youth Eco Act**” i cili është financuar nga Grantet Operacionale të programit “Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në fushën e Mjedisit në Shqipëri (SENiOR-II) që zbatohet nga REC - Qendra Rajonale e Mjedisit në Shqipëri, projektin “**Clean today -Healthy Tomorrow**” me mbështetjen e Raiffeisen Invest, partnere në projektin Erasmus + “**Të rinjtë dorë për dorë për të pastruar detet**” së bashku me Drejtorinë e Rinisë dhe Sporteve në Bashkinë e Stambollit dhe së fundmi projektin tjetër Erasmus + “**Green Up!**” me Chrześcijańska Służba Charytatywna Oddział Dolnośląski, Wrocław, Poland për post tyre janë edhe një sërë projektesh të tjera.

Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” ka fituar projektin “**Youth Guide for Durrës**” i cili mbështetet nga Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Në kuadër të këtij projekti do të zhvillohen disa trajnime dhe aktivitete në të cilat nevojiten trajnierë dhe ekspertë për të udhëzuar të rinjtë pjesëmarrës. Shoqata do të kontraktojë 6 trajnerët dhe ekspertët të cilët do të zgjidhen përmes këtij procesi tenderimi. Trajnimet dhe aktivitetet do të zhvillohen në qytetin e Durrësit dhe do të përfshijnë gjimnazistë dhe studentë, të cilët në fund të ciklit të trajnimeve do të paisen me njohuritë e duhura për të qenë guida në qytetin e Durrësit. Në këtë mënyrë rriten shancet e tyre për punësim dhe për krijimin e sipërmarrjeve rinore në qytet.

Qëllimi i Thirrjes

Synimi i përgjithshëm i Ekspertëve/Trajnerëve është të zhvillojnë trajnimet 6 (gjashtë) ditore me qëllim rritjen dhe thellimin e njohurive të të rinjve mbi organizimin e guidave në qytetin e Durrësit. Forcimi i kapaciteteve të rinjve në përdorimin e TIK është qëllim kryesor i këtij trajnimi. Numri i barabartë mes pjesëmarrësve femra dhe meshkuj do të ruaj balancat në tregun e punës.



Qëllimet e Projektit

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është:

Ofrimi i mundësive të punësimit dhe vetëpunësimit për rininë lokale duke rritur rolin e tyre në zhvillimin e turizmit në Bashkinë e Durrësit. Përmes këtij projekti synohet të ulet numri i të rinjve që largohen nga Shqipëria dhe rritja e cilësive të jetesës brenda vendit.

Objektivat specifik:

- 1) Zhvillimi i aftësive të të rinjve përmes Trajnimit për Zhvillimin e Aftësive, për të krijuar mundësi për vet- vetëpunësim si guida në qytetin e Durrësit.
- 2) Forcimi i kapaciteteve të të rinjve në përdorimin e TIK, për promovimin e turizmit dhe burimeve të tjera të zonës si mënyrë për të gjeneruar të ardhura.
- 3) Krijimi i partneriteteve me operatorë të sektorit të turizmit për promovimin e Durrësit si një destinacion vjetor.

Data dhe vendi i trajnimit:

Trajnimi për Zhvillimin e Aftësive do të zhvillohet në qytetin e Durrësit i ndarë në cikle nga muaji korrik deri në muajin shtator.

Profili i kërkuar i trajnerëve / ekspertëve

- Diplomë Universitare; Studime pasuniversitare
- Eksperienca të më parshme me grupet rinore, mentorim dhe lehtësim të tyre, punonjës rinor
- Njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Aftësi të mira në shkrimin e raporteve;

Trajnerët/ekspertët pritet të kenë:

- Shkathtësi shumë të mira në gjuhën shqipe/ angleze: aftësia për të drejtuar seanca trajnimi dhe hartimi të materialeve të shkruara (dorëheqje, skica të seancave, raporte) në gjuhën shqipe/angleze.
- Përvojë thelbësore për të punuar si trajner në fushën e rinisë, politikave të punësimit, guidës, shkrimit të materialeve, dije të gjerë mbi TIK, etj.
- Përvojë për të punuar si trajner në kurse të ndryshme të trajnimit që kanë një dimension ndërkulturor ose ndërkombëtar (duke bërë bashk të rinjtë nga vende të ndryshme). Preferohet: Përvoja me trajnime në kontekstin e Europës.



- Shtesë: Përvoja në punën në programe të tjera (ndërkombëtare) për të rinjtë mund të jetë një plus për aplikantin.
- Njohuri dhe përvojë si trajner në fushat relevante për këtë trajnim.
- Njohuri dhe përvojë në fushat relevante të TIK.
- Shtesë: Përvoja në punën në programe të tjera (ndërkombëtare) të fushës së TIK dhe Multimedia, është një vlerë e shtuar e aplikantit.
- Shkathtësi kompjuterike adekuate (MS Office).
- Aftësi për të punuar në mënyrë konstruktive në një ekip.

Numri i trajnerëve/ekspertëve

Për këtë qëllim Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” do të kontraktojë **6 trajnerë**.

Kontratrat dhe Tarifat

Trajnerët e përzgjedhur do të ftohen për të nënshkruar një Kontratë Shërbimi me Shoqatën “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare”, Durrës. Kontrata do të lidhet në LEK. Pagesa do të bëhet në një këst pas përfundimit të detyrave të përfshira nga caktimi i Shoqatës “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” Durrës, është përgjegjës për pagimin e të gjitha taksave që lidhen me këtë detyrë.

Numri i ditëve të punës përcaktim:

- **Përgatitja e modulit: 2 ditë**
- **Zhvillimi i Trajnimit: 3 ditë për trajner (1 (një) ditë për secilin grup)**
- **Vlerësimi dhe Raportimi: 1 ditë**

Totali: 6 ditë



Procesi i Aplikimit

Dorëzimi i dokumenteve

Kandidatëve të interesuar u kërkohet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. CV në Shqip (preferohet në Euro Pass).
2. Kopje të diplomës dhe kualifikimeve të tjera
3. Një letër në të cilën:
 - Jep shembuj konkretë se si përvoja dhe aftësitë e aplikantit përmbushin detyrën (bazuar në kriteret e listuara për profilin e trajnerëve);
4. Ofroni informata nga dy referenca të cilët mund të kontaktohen nga Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare”.

Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve në thirrjen aktuale për trajnerët / ekspertët është 08 Korrik 17:00 CET.

Dokumentet do të dërgohen në info@udhetimilire.org dhe/ose udhetimilire@gmail.com

Ju lutemi tregoni në e-mail tekstin e mëposhtëm: Aplikimi për Thirrje për Trajnerë/ Ekspertë për projektin “Youth Guide for Durrës”.

Kriteret e përzgjedhjes

Trajnerët do të përzgjidhen nga komisioni i përzgjedhjes i përbërë nga stafi i Shoqatës “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare”. Procesi i përzgjedhjes do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga thirrja aktuale për trajnerët / ekspertët.

Aplikimi i paraqitur pas afatit nuk do të konsiderohet për vlerësim dhe përzgjedhje.

Çdo aplikim do të gjykohet sipas kriterëve të sipër përmendura.

Preferohen ekspertë/trajnerë nga Durrësi.



Kalendari indikativ i thirrjes

AKTIVITETI	AFATI	KOHA
Lancimi i thirrjes	29 Qershor 2019	12:00 CET
Afati I fundit për dorëzimin e aplikimeve	08 Korrik 2019	17:00 CET
Informacion mbi përzgjedhjen	10 Korrik 2019	17:00 CET

Ky afat kohor mund të përditësohet nga Shoqata “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare” Durrës gjatë procedurës. Në raste të tilla, orari i azhurnuar do të publikohet në faqen e internetit të Shoqatës “Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare: www.udhetimiilire.org

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë Thirrje për trajnerët / ekspertët, ju lutemi kontaktoni në adresën e e-mail: info@udhetimiilire.org dhe/ose udhetimilire@gmail.com